

Vendim nr. 168, datë 25.05.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari, Kryesuese

Ilir Toska, Anëtar

Genti Ibrahimimi, Anëtar

në datën 25.05.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (M) 2026 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **MARK PRENGA**

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-3332, datë 17.09.2025 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtuësishëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 52, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është liruar nga ushtria në vitin 1974 dhe në vitin 1976 ka marrë titullin “oficer rezervist”. Nga viti 1981 deri në vitin 1991 ai ka kryer detyrën e komandantit të batalionit vullnetar pranë Këshillit të Bashkuar, Gjegjan, Pukë.

2. Kërkuesi në datën 04.11.2015 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesë, me objekt vërtetimin e faktit juridik të qenies në marrëdhënie punë si ish-ushtarak. Pas shqyrtimit të kërkesës, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 173, datë 24.03.2016, ka vendosur: i) pranimin e kërkesës; ii) vërtetimin e faktit juridik se kërkuesi ka punuar në ish-repartin ushtarak, Rrëshen, Mirditë, për periudhën 01.04.1984-30.04.1994; iii) vërtetimin e faktit juridik se kërkuesi ka punuar në ish-repartin ushtarak, Gjegjan, Pukë për periudhën 15.09.1997-01.04.2013.

3. Në datën 06.07.2016 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesë për sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 173, datë 24.03.2016, duke përcaktuar qartë vërtetimin e faktit se kërkuesi ka punuar si ushtarak për periudhën 15.09.1997-01.04.2013. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 1070, datë 14.12.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për sqarimin dhe interpretimin e vendimit (*shih paragrafin 2 të vendimit*).

4. Pas ankimit të kërkuesit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 91, datë 02.11.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar kërkesën për sqarimin dhe interpretimin në këtë mënyrë: vërtetimin e faktit juridik se kërkuesi ka punuar si ish-ushtarak në repartin ushtarak, Gjegjan, Pukë për periudhën 15.09.1997-01.04.2013 (vendimi është pjesë përbërëse e vendimit nr.173 datë. 24.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë).

5. Pas kërkesës së kërkuesit për njohjen dhe pajisjen me vërtetim për karrierën e tij si ish-ushtarak për periudhën 1975-1991, me detyrën “oficer rezervist”, Qendra e Personel Rekrutimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes, me shkresën e datës 30.04.2018, i ka kthyer përgjigje se për të (kërkuesin) nuk disponohet dosje personale ose ndonjë dokumentacion tjetër që të vërtetojë karrierën e tij si nënoficer aktiv.

6. Në datën 20.06.2018 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë me kërkesë për vërtetimin e faktit juridik: i) qenien në marrëdhënie pune si ushtarak për periudhën 1975–1991 në Shkollën e Lirë Ushtarake Gjegjan, Pukë dhe në detyrën komandat batalioni në batalionin vullnetar pranë Këshillit të Bashkuar, Gjegjan, Pukë (gjithsej 819 ditë shërbim, periudhë e ndarë ndër vite); ii) marrëdhënien e punës në ndërmarrjen e ndërtimit Pukë për periudhën 01.04.1975 - 15.12.1975.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. 629, datë 15.10.2018, ka pranuar pjesërisht kërkesën, duke vendosur vërtetimin e faktit juridik të qenies në marrëdhënie pune për periudhën 01.04.1975-15.12.1975 si punonjës në ndërmarrjen e ndërtimit Pukë dhe duke rrëzuar pjesën tjetër (kërkimin e parë). Pas ankimit të kërkuarit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 451, datë 01.07.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 629, datë 15.10.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Pas ushtrimit të rekursit nga kërkuari, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, gjatë procesit të seleksionimit, me vendimin nr. 00-2025-3332, datë 17.09.2025, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit në zbatim të nenit 480, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pasi shkaqet e paraqitura në rekurs janë të ndryshme nga ato që i lejon ligji.

8. Kërkuari në datën 25.02.2026 i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuarit

9. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se është cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor* në aspektet e mëposhtme:

9.1.1. *E drejta e aksesit*, pasi Gjykata e Lartë ka mohuar të drejtën për të përfituar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi si ushtarak për periudhën e kërkuar dhe pa të drejtë ka vendosur mospranimin e rekursit, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit. Gjatë gjykimit kërkuari ka paraqitur prova/deklarata të personave që kanë punuar me të, sipas të cilave ai ka kryer detyrën e komandantit të batalionit. Gjykatat e faktit nuk kanë kryer hetim të plotë dhe nuk kanë lejuar marrjen në pyetje të dëshmitarëve. Gjykata e Lartë duhet ta kishte shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore, për t'i krijuar mundësinë për të paraqitur parashtrimet e tij.

9.1.2. *E drejta për gjykim të drejtë*, pasi vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë bazuar në nenet 62 dhe 86 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të cilat nuk përcaktojnë pozitën juridike të ushtarakut për përfitimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, gjë që rregullohet nga legjislacioni i posaçëm.

9.1.3. *Parimi i paanshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë e ka paragjykuar çështjen dhe nuk ka zbatuar praktikën e mëparshme. Gjithashtu, edhe gjyqtarja e gjykatës

së apelit është treguar shumë agresive, duke refuzuar të dëgjoje pretendimet e kërkuarit.

9.1.4. *E drejta për gjykim brenda një afatit të arsyeshëm*, pasi rekursi është depozituar në datën 22.07.2019 dhe është marrë në dhomën e këshillimit në datën 17.09.2025, pas një periudhe prej më shumë se 6 vjetësh, duke shkelur nenin 480 të KPC-së, që parashikon se shqyrtimi i rekursit bëhet brenda 60 ditëve nga depozitimi i rekursit.

9.2. *Parimi i sigurisë juridike*, pasi Gjykata e Lartë ka vënë në dyshim të drejtën për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në rast të punësimit, e cila është e drejtë e fituar me ligjin nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe me ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë në kundërshtimin edhe me vendimin nr. 173, datë 24.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (interpretuar nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 91, datë 02.11.2017), sipas të cilit kërkuarit i është njohur puna si ish-ushtarak për periudhën 15.09.1997-01.04.2013 në repartin ushtarak në Gjegjan, Pukë. Po sipas këtij vendimi (nr. 173, datë 24.03.2016) kërkuarit i është njohur puna në repartin ushtarak në Rrëshen për periudhën 01.04.1984-30.04.1994. Duke pasur parasysh këto vendime, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë gabuar duke konsideruar periudhën e kërkuar si periudhë zbori, kur jo periudhë nuk mund të ishte më shumë se 12 ditë në vit.

9.3. *E drejta për pension*, e garantuar në nenin 52 të Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë i ka mohuar kërkuarit një të drejtë të fituar me ligj, duke i cenuar edhe nivelin e jetesës, në kushtet kur kjo e drejtë nuk parashkruhet. Kërkuari nuk ka kërkuar vite shtesë, por t’i pranohet periudha në stërvitje ushtarake. Kërkesa nuk ka pasur lidhje me njohjen e viteve të punës në ushtri, por ka lidhje me cilësinë e punës nga civil në ushtarak.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1,

shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Kolegji vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, sepse është palë në procesin gjyqësor objekt kundërshtimi, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

12. Një kriter tjetër paraprak lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i përcaktuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet asaj.

13. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se kriteri për shterimin e mjeteve juridike efektive nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë paraprakisht në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin *subsidiar* që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes të të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 14, datë 11.03.2021; nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në drejtim të analizës të kriterit të shterimit të mjeteve juridike, kërkuesi ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm* nga Gjykata e Lartë. Lidhur me këtë kërkim, evidentohet se në datën 05.11.2017 kanë hyrë në fuqi ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, sipas të cilave, individët kanë në dispozicion mjetin juridik të kërkesës që u drejtohet gjykatave të zakonshme për përshpejtimin e procedurave dhe konstatimin e shkeljes (nenet 399/1 e vijues të KPC-së). Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se këto mjete ligjore për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë

efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji vëren se kërkuesi nuk i ka bashkëlidhur ankimit kushtetues individual ndonjë akt që të provojë se ka përdorur mjetet ligjore që ka pasur në dispozicion. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për pretendimin për *cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar edhe *cenimin e parimit të paanshmërisë*, duke paraqitur dy argumente: a) Gjykata e Lartë e ka paragjykuar çështjen; b) gjyqtarja e gjykatës së apelit nuk ka dëgjuar pretendimet e tij. Për argumentin e dytë, Kolegji konstaton se kërkuesi në rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë nuk ka parashtruar pretendime për paanshmërinë e gjyqtarës të gjykatës së apelit. Këtë pretendim ai e ka paraqitur vetëm në ankimin kushtetues individual, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet efektive juridike në dispozicion për efekt të gjykimit kushtetues, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

17. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ai nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

18. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 17.09.2025, i cili është bërë i disponueshëm në datën 06.11.2025. Ndaj kërkesa e paraqitur në Gjykatë në datën 25.02.2026 është brenda afatit ligjor 4-mujor dhe kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* për paraqitjen e saj.

19. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka parashtruar pretendime për *cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 të Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit, gjykimit të drejtë, parimit të paanshmërisë dhe parimit të sigurisë juridike, si dhe së drejtës për pension, të garantuar nga neni 52 të Kushtetutës.

20. Në lidhje me pretendimin për *cenimin e së drejtës së aksesit*, Kolegji vëren se, mes të tjerave, kërkuesi ka parashtruar se Gjykata e Lartë duhet ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore. Neni 480 i KPC-së parashikon shqyrtimin nga Gjykata e Lartë të kushteve të pranueshmërisë së rekursit në dhomën e këshillimit. Më tej, në rastin kur rekursi plotëson këto

kushte, çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore, si rregull, në dhomën e këshillimit mbi bazë të dokumenteve (*neni 482 i KPC-së*) ose në prani të palëve (*neni 482/a i KPC-së*). Në analizë të përmbajtjes së këtyre dispozitave, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u dëgjuar nuk nënkupton vetëm atë për t'u dëgjuar personalisht përpara gjykatës, pasi ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, pra nëpërmjet komenteve dhe shpjegimeve të dhëna me shkrim nga palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në zbatim të këtyre parashikimeve ligjore, Kolegji vëren se rekursi i kërkuarit i është nënshtruar shqyrtimit paraprak të pranueshmërisë, shqyrtim ky që lidhet me verifikimin e kushteve formale të paraqitjes së tij dhe të ekzistencës së shkaqeve të lejuara nga ligji, qoftë në aspektin formal, ashtu edhe në atë substancial, duke u mbështetur në aktet e dosjes gjyqësore. Në këto rrethana, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se nuk ndodhë përpara ndonjërit prej rasteve për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, ndaj Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit është haptazi i pabazuar.

21. Gjithashtu, kërkuari ka pretenduar se vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm kanë cenuar *parimin e sigurisë juridike*, pasi ai i ka fituar të drejtat e tij me vendimin nr. 173, datë 24.03.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë (interpretuar nga Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr. 91, datë 02.11.2017).

22. Sikurse u parashtrua në rrethanat e çështjes, por edhe nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore, Kolegji vëren se vendimi nr. 173, datë 24.03.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë lidhet me vërtetimin e faktit të qenies në marrëdhënie pune si ish-ushtarak në ish-repartin ushtarak në Rrëshen dhe në Pukë. Ndërsa me vendimin nr. 629, datë 15.10.2018 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit për vërtetimin e faktit juridik të qenies në marrëdhënie pune si ushtarak për periudhën 1975–1991 në Shkollën e Lirë Ushtarake Gjegjan, Pukë, në detyrën e komandat batalioni pranë Këshillit të Bashkuar Gjegjan, Pukë (gjithsej 819 ditë shërbim, periudhë e ndarë ndër vite) dhe në ndërmarrjen e ndërtimit Pukë për periudhën 01.04.1975-15.12.1975. Për rrjedhojë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka shqyrtuar kërkesa me objekte të ndryshme e për periudha të ndryshme kohore. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se në rastin konkret nuk jemi përpara gjësë së gjykuar dhe se kërkuari nuk ka parashtruar argumente kushtetuese për të provuar *cenimin e parimit të sigurisë juridike në aspekt të gjësë së gjykuar*, ndaj pretendimi është haptazi i pabazuar.

23. Për sa u përket pretendimeve të tjera, për *cenimin e së drejtës së aksesit, së drejtës për gjykim të drejtë, parimit të paanshmërisë*, pasi Gjykata e Lartë ka paragjykuar çështjen dhe nuk ka zbatuar praktikën e mëparshme, dhe *së drejtës për pension*, Kolegji vëren se kërkuari ka parashtruar të njëjtat argumente që lidhen me vendimmarrjen e gjykatave të juridiksionit të

zakonshëm, të cilat duke mos i njohur periudhën e punës në Shkollën e Lirë Ushtarake kanë cenuar edhe e drejta për pension.

24. Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se argumentet për cenimin e së drejtës për pension lidhen me procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuesit, çmon t'i trajtojë pretendimet e paraqitura në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës. Gjithashtu, nisur nga thelbi i argumenteve të parashtruara nga kërkuesi, në mbështetje të pretendimeve të tij, Kolegji konstaton se ato kanë të bëjnë me të drejtën e aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do t'i analizojë në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

25. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka mohuar të drejtën për të përfutur pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi si ushtarak për periudhën e kërkuar dhe pa të drejtë ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi kërkuesi ka paraqitur prova/deklarata të personave që kanë punuar me të, sipas të cilave ai ka kryer detyrën e komandantit të batalionit.

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 03.11.2022; nr. 5, datë 22.02.2022; nr. 22, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar vazhdimisht qëndrimin e saj të konsoliduar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material janë, si rregull, atribut i gjykatave të zakonshme, ndërsa detyra e saj është të sigurojë nëse procesi në tërësinë e tij ka qenë i rregullt. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit

për proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 41, datë 22.12.2022; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 4, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Në rastin konkret, Kolegji vëren se procesi gjyqësor ka nisur nga kërkuesi, i cili ka kërkuar vërtetimin e faktit juridik të qenies në marrëdhënie pune si ushtarak për periudhat 1975–1991 në Shkollën e Lirë Ushtarake Gjegjan, Pukë dhe në detyrën e komandantit të batalionit në batalionin vullnetar pranë Këshillit të Bashkuar Gjegjan, Pukë (gjithsej 819 ditë shërbim, periudhë e ndarë ndër vite), si dhe në ndërmarrjen e ndërtimit Pukë për periudhën 01.04.1975 - 15.12.1975. Gjykata e shkallës së parë ka pranuar vetëm kërkimin për qenien në marrëdhënie punë për periudhën 01.04.1975-15.12.1975 si punonjës në ndërmarrjen e ndërtimit Pukë dhe duke rrëzuar kërkimin tjetër. Sipas gjykatës së shkallës së parë për këtë periudhë (si punonjës në ish-ndërmarrjen e ndërtimit Pukë) kërkuesi i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër për t’u pajisur me dokumentacion për vjetërsinë në punë. Kjo drejtori, në përgjigje të kërkesës së tij, ka lëshuar akt verifikimi, të datës 10.05.2018, sipas të cilit kërkuesi figuron të ketë punuar në ish-ndërmarrjen e ndërtimit Pukë nga data 01.04.1975 deri më 15.12.1975. Sipas gjykatës së shkallës së parë, ky fakt vërtetohet në mënyrë të qartë dhe përbën provë të vlefshme, në përputhje me nenin 388/1 të KPC-së, i cili lejon vërtetimin e një fakti juridik kur dokumentacioni mungon dhe nuk mund të riprodhohet (*shih faqen 4 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë*). Vendimi është lënë në fuqi nga gjykata e apelit me të njëjtën linjë arsyetimi dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit në zbatim të nenit 480, shkronja “a”, të KPC-së.

30. Nën dritën e këtyre rrethanave, Kolegji, duke e vlerësuar çështjen në respektim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe në analizë të vendimmarrjes së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, çmon se ato u kanë dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit dhe se ato në thelb lidhen me mënyrën sesi gjykatat kanë vlerësuar provat dhe kanë zbatuar ligjin për zgjidhjen e çështjes. Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë, Gjykata ka theksuar se nëse Kolegji në dhomën e këshillimit kur krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Kjo është edhe përgjigjja që Gjykata e Lartë u jep pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se interpretimi e zbatimi i ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në lidhje me përfundimin e arritur nuk është arbitrar dhe se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor *në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor* është haptazi i pabazuar. Në kushtet kur ndaj tij nuk ka pasur shkelje të së drejtës për proces të rregullt ligjor edhe pretendimi për cenimin *e së drejtës për pension* është haptazi i pabazuar.

32. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.